

RAPORT

# Vlerësimi i iniciativës të autobusëve falas në Komunën e Kamenicës

Tetor 2024

FRIEDRICH  
EBERT   
STIFTUNG

## IMPRESUM

Publikuar nga: Zyra e Fondacionit Friedrich Ebert – Prishtinë,  
Pashko Vasa 23, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
+ 383 38 600 108; info@fes-kosovo.org, Web: kosovo.fes.de

Personi përgjegjës:  
Peter Hurrelbrnik

Menaxhere e Programeve:  
Rudina Nallbani Hoxha

Dizajni i hulumtimit, metodologjia dhe autorët:  
IDRA Research and Consulting

Paraqitja dhe dizajni:  
Milky Way Creative

Shtypur nga:  
Studio Forma

Data:  
Tetor 2024

Autori merr përgjegjësinë e plotë për përmbajtjen e botimit.  
Mendimet e shprehura nuk janë domosdoshmërisht ato të  
Friedrich Ebert Stiftung.

# Përmbajtja

Përmbledhje ekzekutive	6
Hyrje	7
Pasqyrim i kontekstit: Transporti në Kosovë	8
Korniza Ligjore për Transportin në Kosovë	8
Transporti i udhëtarëve	8
Transporti publik	8
Përgjegjësitë për sigurimin e transportit publik	9
Strategjia e transportit multimodal 2023-2030 dhe marrëveshjet Evropiane	10
Marrëveshja e gjelbër evropiane dhe direktivat e BE-së	10
Metodologjia	12
Shpërndarja e anketave	12
Intervistat e thelluara	12
Rezultatet dhe diskutimet	13
Arsyet prapa nismës së autobusëve falas dhe planet e së ardhmes	13
Profili demografik i të anketuarve	14
Përdorimi i shërbimit	18
Qasja dhe Përfshirja	22
Niveli i përgjithshëm i kënaqësisë	24
Ndikimet në mjedis	28
Ngarkesa e trafikut	30
Kanalet e informimit	32
Gatishmëria për të paguar	33
Linjat e preferuara të autobusëve dhe dixhitalizimi i shërbimit	34
Përfundime dhe rekomandime	36
Referencat	38

## Lista e figurave

<b>Figura 1.</b>	Shpërndarja e grupmohave të të anketuarve	14
<b>Figura 2.</b>	Shpërndarja sipas gjinisë	15
<b>Figura 3.</b>	Statusi i punësimit të të anketuarve	15
<b>Figura 4.</b>	Shpërndarja e të anketuarve sipas vendbanimit	16
<b>Figura 5.</b>	Pronësia e veturës	16
<b>Figura 6.</b>	Gjendja civile e të anketuarve	17
<b>Figura 7.</b>	Anëtarët e familjes që banojnë në një familje/shtëpi	17
<b>Figura 8.</b>	Prindi ose kujdestari kryesor	17
<b>Figura 9.</b>	A mund të më thoni përafërsisht, sa herë e keni përdorur këtë autobus që kur ka filluar të funksionojë në fillim të shtatorit?	18
<b>Figura 10.</b>	Cila është arsyeja e përdorimit të autobusit për këtë udhëtim?	18
<b>Figura 11.</b>	Cilat janë tre arsyet kryesore për përdorimin e këtij autobusi tani apo potencialisht në të ardhmen?	19
<b>Figura 12.</b>	Cilat janë tre arsyet kryesore për përdorimin e këtij autobusi tani apo potencialisht në të ardhmen? Sipas llojit të vendbanimit	19
<b>Figura 13.</b>	A e ka lehtësuar shërbimi falas i autobusit transportin e fëmijëve tuaj në shkollë?	20
<b>Figura 14.</b>	Në cilin stacion autobusi hipët për të shkuar në destinacionin e dëshiruar?	20
<b>Figura 15.</b>	Sa kohë ju është dashur për të arritur në stacionin e autobusit nga shtëpia juaj?	21
<b>Figura 16.</b>	Në cilën orë të ditës udhëtoni zakonisht? (përgjigje e shumëfishtë)	21
<b>Figura 17.</b>	Kur shërbimi i autobusit falas nuk ishte i disponueshëm, si keni udhëtuar kryesisht? (përgjigje e shumëfishtë)	22
<b>Figura 18.</b>	A i keni vënë re veçoritë e mëposhtme të qasjes në autobus? (përgjigje e shumëfishtë)	22
<b>Figura 19.</b>	Si do ta vlerësonit lehtësinë e qasjes në shërbimin e autobusëve për personat me aftësi të kufizuara ose me sfida të lëvizshmërisë?	23
<b>Figura 20.</b>	A jeni dakord që shërbimi i autobusit është gjithëpërfshirës dhe i qasshëm për të gjithë qytetarët, pavarësisht nga aftësitë e tyre fizike apo statusi socio-ekonomik?	23
<b>Figura 21.</b>	A jeni dakord që shërbimi i autobusit është gjithëpërfshirës dhe i qasshëm për të gjithë qytetarët, pavarësisht nga aftësitë e tyre fizike apo statusi socio-ekonomik? Sipas grupmohave	24
<b>Figura 22.</b>	Sa i/e kënaqur jeni në përgjithësi me shërbimin falas të autobusëve?	24
<b>Figura 23.</b>	Sa të kënaqur jeni në përgjithësi me shërbimin falas të autobusëve? Sipas grupmohave	25
<b>Figura 24.</b>	Si do ta vlerësonit përpikmërinë e autobusëve (kohët e mbërritjes/nisjes)?	25
<b>Figura 25.</b>	Sa komod janë autobusët (sediljet, pastërtia, temperatura)?	26
<b>Figura 26.</b>	Sa i përshtatshëm është shërbimi i autobusit për sa i përket itinerarit dhe orareve?	26
<b>Figura 27.</b>	Sa i përshtatshëm është shërbimi i autobusit për sa i përket orarit? Sipas llojit të vendbanimit	27
<b>Figura 28.</b>	Si do ta vlerësonit ndërveprimin tuaj me drejtuesit e autobusëve?	27
<b>Figura 29.</b>	Që kur është futur shërbimi falas me autobus, a e keni reduktuar përdorimin e automjetit personal?	28
<b>Figura 30.</b>	Që kur është futur shërbimi falas i autobusëve, a e keni reduktuar përdorimin e makinës personale? Sipas llojit të vendbanimit	28
<b>Figura 31.</b>	A besoni se përdorimi i shërbimit të autobusit në vend të makinës ka një ndikim pozitiv në uljen e ndotjes së ajrit?	29
<b>Figura 32.</b>	A besoni se përdorimi i shërbimit të autobusit në vend të automjetit ka një ndikim pozitiv në uljen e ndotjes së ajrit? Sipas grupmohës	29
<b>Figura 33.</b>	A keni më shumë gjasa të përdorni transportin publik nëse ai ndihmon në uljen e ndotjes së mjedisit?	30
<b>Figura 34.</b>	A keni vënë re ndonjë ndryshim në kushtet e trafikut (dmth. mbingarkesë) që nga fillimi i shërbimit falas të autobusëve?	30
<b>Figura 35.</b>	A keni përjetuar ndryshime në qëndrueshmërinë e parkimit për shkak të shërbimit falas të autobusëve?	31

<b>Figura 36.</b>	Si dëgjuat për herë të parë për nismën e autobusëve falas?	32
<b>Figura 37.</b>	Si dëgjuat për herë të parë për nismën e autobusëve falas?; sipas llojit të vendbanimit	32
<b>Figura 38.</b>	Si dëgjuat për herë të parë për nismën e autobusëve falas? Siipas grupmoshës	33
<b>Figura 39.</b>	Nëse shërbimi falas i autobusit do të vazhdonte si shërbim me pagesë, sa do të ishit të gatshëm të paguanit për të?	33
<b>Figura 40.</b>	Cili do të ishte motivimi juaj kryesor për të përdorur shërbimin e autobusit?	34
<b>Figura 41.</b>	Nëse mund të sugjeroni ndonjë itinerar të ri autobusi ose modifikim të itinerareve ekzistuese, cilat zona apo lagje do të preferonit?	34
<b>Figura 42.</b>	Dëshironi që informacioni për linjat e autobusëve të jetë online/dixhitalizuar?	35

## Lista e tabelave

<b>Tabela 1.</b>	Shpërndarja e anketës	12
------------------	-----------------------	----

## Përmbledhje ekzekutive

Nisma e autobusëve falas në Komunën e Kamenicës u lansua për të adresuar nevojat e transportit të qytetarëve të Komunës, posaçërisht të grupeve të rrezikuara të qytetarëve, si të moshuarve, të rinjve dhe grave. Gjeografia e larmishme e komunës dhe mundësitë e kufizuara të transportit kanë lënë shumë fshatra të izoluar, duke penguar qasjen në shërbimet thelbësore si arsimit, kujdesit shëndetësor dhe mundësitë e punësimit. Qëllimi kryesor i nismës është të përmirësojë mobilitetin dhe qasjen në burimet jetike dhe të kontribuojë në qëllimet më të gjera të qëndrueshmërisë mjedisore dhe barazisë sociale.

Gjetjet e anketës tregojnë se shërbimi i autobusëve luan një rol kritik në mbështetjen e aktiviteteve të përditshme. Një pjesë e konsiderueshme 65.3% e të anketuarve identifikuan kryerjen e punëve të përditshme, duke përfshirë blerjet dhe marrjen e dokumenteve zyrtare, si arsien kryesore për përdorimin e shërbimit. Megjithatë, vlen të përmendet se 42.9% e të anketuarve kanë raportuar se kanë përdorur autobusin vetëm një herë që nga fillimi i funksionimit të tij. Kjo sugjeron që ndërkohë që shërbimi është i disponueshëm, ka potencial të konsiderueshëm për rritjen e numrit të udhëtarëve, veçanërisht ndërsa rritet ndërgjegjësimi i qytetarëve për përfitimet e tij dhe bëhen përmirësime në linjat dhe oraret e autobusëve.

Për sa i përket qasjes, iniciativa është pritur mjaft mirë, me 93.5% të të anketuarve që e përshkruajnë shërbimin si të lehtë për t'u qasur dhe 96.5% besojnë se ai është gjithëpërfshirës për të gjithë qytetarët, pavarësisht nga aftësia fizike apo statusi socio-ekonomik. Megjithatë, mbeten boshllëqe, veçanërisht në lidhje me qasjen për individët me aftësi të kufizuara. Vetëm 4.8% e të anketuarve raportuan se në këto linja të autobusit kishin parë hapësira të caktuara për përdoruesit e karrocave me rrota. Kjo mund të nënkuptojë që hapësirat nuk ishin të mjaftueshme ose që pasagjerët nuk i kanë vënë re duke theksuar nevojën për një dizajn apo vizibilitet më të mirë për të siguruar qasje për të gjithë.

Për sa i përket ndikimeve mjedisore, nisma ka nxitur ndryshime pozitive në sjellje. Ndër të anketuarit që posedojnë ose kanë qasje në automjete personale, 29% raportuan ulje të ndjeshme të përdorimit të automjetit që nga fillimi i shërbimit të autobusëve, ndërsa 17.4% vunë re një rënie mesatare. Megjithatë, 42% treguan se nuk e kanë zvogëluar përdorimin e automjeteve personale, duke sugjeruar nevojën për një ndërgjegjësim më të madh për përfitimet e përdorimit të transportit publik.

Për të rritur efektivitetin dhe qëndrueshmërinë e nismës së autobusëve falas në Kamenicë, propozojmë disa rekomandime kryesore:

### • Përmirësimi i linjave dhe orareve të autobusëve:

Bashkëpunimi i vazhdueshëm me palët e interesit në komunën e Kamenicës dhe qytetarëve për të mbledhur komente për linjat dhe oraret e autobusëve. Ky bashkëpunim do të ndihmojë në përshtatjen e shërbimeve për të përbushur më mirë nevojat e banorëve dhe njëkohësisht për të rritur numrin e udhëtarëve.

• **Zbatimi i një fushate ndërgjegjësimi:** Nisja e një fushate gjithëpërfshirëse për të promovuar përfitimet mjedisore të transportit publik dhe avantazhet e përdorimit të shërbimit të autobusit në vend të automjeteve personale. Kjo nismë duhet të fokusohet në vetëdijësimin e banorëve se si rritja e përdorimit të autobusëve mund të çojë në reduktimin e ndotjes së ajrit dhe zhblokimin e trafikut.

• **Zgjatja e orarit të shërbimit:** Zgjatja e orarit të autobusëve, veçanërisht gjatë orëve të ngarkuara dhe fundjavave, mund të ndihmojë banorët me orare pune të gjata dhe të përmirësojë qasjen në aktivitetet e tyre të kohës së lirë.

• **Krijimi i programeve të besnikërisë:** Krijimi i programeve të besnikërisë që shpërblejnë qytetarët që udhëtojnë shpesh me zbritje në pagesën e autobusit nëse ky shërbim në të ardhmen ofrohet me pagesë. Kjo qasje do të krijojë një lidhje më të fortë midis qytetarëve dhe shërbimit të autobusit, duke inkurajuar më shumë njerëz që të përdorin transportin publik.

• **Përmirësimi i qasjes:** Duhet dhënë përparësi krijimit të hapësirave të caktuara për përdoruesit e karrocave me rrota dhe veçorive të tjera që rrisin qasjen për individët me aftësi të kufizuara. Ky përkushtim ndaj gjithëpërfshirjes jo vetëm që do të përmirësojë përvojën për përdoruesit me aftësi të kufizuara, por gjithashtu do të forcojë perceptimin e qytetarëve për shërbimin e autobusëve si një opsion i qëndrueshëm transporti për të gjithë.

• **Shfrytëzimi i subvencioneve në dispozicion:** Gjithashtu është e rëndësishme të eksplorohet potenciali për aplikimin e subvencioneve të përshkruara në Udhëzimin Administrativ Nr. 26/2017, i cili ofron mbështetje financiare (0.20 EUR) për linjat e transportit ndërrurban ekonomikisht të paqëndrueshme. Duke shfrytëzuar këto subvencione, Komuna e Kamenicës mund të mbajë një rrjet të fuqishëm të transportit publik që plotëson nevojat e ndryshme të banorëve të saj duke siguruar qëndrueshmëri financiare.

Duke u fokusuar në këto rekomandime, nisma e autobusëve në Kamenicë mund të vazhdojë të nxisë lidhjen e qytetarëve, të rrisë përfshirjen dhe të kontribuojë në objektiva më të gjera të qëndrueshmërisë, zhvillimit ekonomik dhe përmirësimit të transportit publik për të gjithë banorët.

# Hyrje

Qëllimi kryesor i këtij studimi hulumtues ishte vlerësimi i ndikimit dhe efektivitetit të një nisme 20-ditore me autobus falas të zbatuar në komunën e Kamenicës. Nisma synonte të promovonte transport të qëndrueshëm duke nxitur aksesin në transport publik për të gjithë banorët, duke promovuar përfshirjen sociale, veçanërisht për grupet e cenuara dhe të nxiste përdorimin e transportit publik për mbrojtje të mjedisit. Për të vlerësuar në mënyrë gjithëpërfshirëse suksesin e nismës në arritjen e këtyre objektivave, ky studim përfshin mbledhjen e të dhënave primare përmes anketave me udhëtarë dhe intervista të thelluara me aktorë kyç. Ky vlerësim synonte jo vetëm të masë kënaqësinë e përdoruesve dhe efikasitetin e shërbimit, por gjithashtu të shqyrtonte efektet më të gjera të nismës në komunitet, modelet e trafikut dhe mjedisin.

IDRA përdori një qasje hulumtuese me metoda të ndryshme, duke kombinuar teknikat sasore dhe cilësore të mbledhjes së të dhënave për të ofruar një analizë të plotë të iniciativës. Procesi i mbledhjes së të dhënave përfshinte dy komponentë kryesorë. Së pari, raporti përfshin kryerjen e anketave me 170 udhëtarë që e kanë përdorur këtë linjë autobusi. Këto anketa janë krijuar për të mbledhur informacione të detajuara mbi aspekte të ndryshme të shërbimit, duke përfshirë shpeshtësinë e përdorimit, arsyet e përdorimit të autobusit, profilet demografike dhe nivelet e përgjithshme të kënaqshmërisë. Theks i veçantë u vu në të kuptuarit se sa i qasshëm dhe gjithëpërfshirës ishte shërbi-

mi për individët me aftësi të kufizuara, si dhe në vlerësimin e perceptimeve të përdoruesve për përfitimet mjedisore të shërbimit dhe rolin e tij në reduktimin e përdorimit të automjeteve private.

Përveç të dhënave sasore të anketës, janë kryer edhe tre intervista të thelluara për të marrë informata më të detajuara cilësore mbi ndikimet operacionale, politike dhe në nivel komuniteti të nismës. Intervistat u zhvilluan me tre aktorë kyç: shoferin e autobusit, departamentin e shërbimeve të transportit rrugor nga ana e Infrastrukturës dhe drejtorinë për zhvillim ekonomik dhe diasporë. Këto intervista kanë ofruar këndvështrime të vlefshme për sfidat e përditshme operacionale me të cilat përballen shoferët e autobusëve, këndvështrimin e pushtetit lokal për kontributin e nismës në politikat më të gjera të transportit dhe përafrimin e nismës me strategjitë kombëtare të infrastrukturës.

Kjo metodologji ofron një kuptim gjithëpërfshirës se si iniciativa e autobusëve falas performoi në përmbushjen e qëllimeve të caktuara dhe të identifikonte fushat ku mund të bëheshin përmirësime të mëtejshme. Nëpërmjet përpjekjeve për mbledhjen dhe raportimin e të dhënave, IDRA synoi t'u sigurojë FES-it dhe autoriteteve vendore njohuri të zbatueshme që do të informonin vendimet e ardhshme të politikave në lidhje me transportin publik, qëndrueshmërinë mjedisore dhe lëvizshmërinë urbane në Kamenicë dhe më gjerë.

# Pasqyrim i kontekstit: Transporti në Kosovë

Ligji i transportit në Kosovë është një komponent kritik i kornizës ligjore të vendit, duke trajtuar mënyra të ndryshme të transportit dhe duke garantuar sigurinë, efikasitetin dhe rregullimin e shërbimeve të transportit. Aspekti ligjor është formuar nga disa ligje dhe rregullore kryesore që rregullojnë transportin rrugor, transportin ajror dhe transportin e mallrave të rrezikshme. Ky rishikim i literaturës shqyrton instrumentet primare ligjore që përbëjnë ligjin e transportit në Kosovë dhe përputhshmërinë e tyre me standardet ndërkombëtare.

## Korniza Ligjore për Transportin në Kosovë

Ligji Nr. 04/L-179 për Transportin Rrugor<sup>1</sup> (në tekstin e mëtejshëm Ligji për Transportin Rrugor) përcakton një kornizë gjithëpërfshirëse rregullative për operimet e transportit rrugor. Ky ligj përshkruan përgjegjësitë e operatorëve të transportit, kërkesat për licencim, standardet e sigurisë dhe të drejtat e pasagjerëve. Objektivat parësore të ligjit janë rregullimi dhe zhvillimi i sektorit si për transportin e udhëtarëve ashtu edhe për mallrat, duke siguruar një qasje të mirëstrukturuar ndaj shërbimeve të transportit. Ai promovon qasje të hapur dhe jodiskriminuese në treg për operatorët e transportit rrugor, duke nxitur konkurrencën e ndershme. Ligji parashikon gjithashtu udhëzime për ofrimin e shërbimeve brenda tregut të transportit rrugor, duke vendosur standarde të qarta për operatorët. Për më tepër, ai vendos rregullore në lidhje me periudhat e drejtimit dhe pushimit të shoferëve, që synojnë promovimin e sigurisë dhe garantimin e pajtueshmërisë së industrisë. Në përgjithësi, ligji synon të rrisë efikasitetin, sigurinë dhe besueshmërinë e transportit rrugor në Kosovë.

## Transporti i udhëtarëve

Transporti i udhëtarëve, siç rregullohet me ligj, përfshin forma të ndryshme të transportit, duke përfshirë shërbimet e rregullta, falas dhe taksi, të cilat mund të ofrohen si për qëllime komerciale ashtu edhe për ato personale. Që çdo operator të angazhohet në transportin e pasagjerëve, ai duhet së pari të marrë një licencë që siguron përputhjen me një sërë kërkesash ligjore. Këto kërkesa synojnë të garantojnë sigurinë, besueshmërinë dhe profesionalizmin e shërbimeve të ofruara. Operatorët duhet gjithashtu të

plotësojnë kushte specifike teknike për automjetet e tyre, duke përfshirë mbajtjen e një flote që plotëson standardet e sigurisë dhe sanitare të ligjit.

Transporti i pasagjerëve ndahet në disa kategori. **transporti i rregullt** organizohet përgjatë rrugëve të paracaktuara me orare dhe tarifa të publikuara dhe i nënshtrohet mbikëqyrjes së ngushtë rregullatore. Kjo kategori përfshin transportin urban dhe periferik brenda qyteteve, transportin ndërrurban që lidh komuna të ndryshme dhe transportin ndërkombëtar, i cili përfshin shërbime ndërkufitare. Të gjithë operatorët që ofrojnë këto shërbime pritet t'i përmbahen rreptësisht orareve, rregullave të biletave dhe kushteve të përcaktuara nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe autoritetet përkatëse komunale.

Përveç transportit të rregullt, ligji parashikon dispozita për **transportin falas**, i cili i referohet shërbimeve të transportit jokomercial për grupe të veçanta udhëtarësh. Shërbime të tilla zakonisht organizohen për punonjësit, studentët ose qytetarët me nevoja të veçanta. Operatorët që ofrojnë këto shërbime duhet të marrin leje speciale dhe shërbimet duhet të kryhen sipas marrëveshjeve kontraktuale që specifikojnë linjat, oraret dhe strukturën e tarifave, edhe nëse shërbimet ofrohen falas për pasagjerët.

**Shërbimet e taksive** janë të rregulluara ndryshe, duke ofruar shërbime fleksibël, të bazuara në kërkesë dhe jo rrugë fikse. Operatorët e taksive duhet të respektojnë kushtet e licencimit dhe duhet të sigurojnë që tarifën e tyre të shfaqen qartë në automjet dhe të llogariten nëpërmjet një taksimetri operativ. Për më tepër, shërbimet e taksive janë të kufizuara në zonat e tyre të caktuara, me drejtuesit e kërkuar të licencohen nga bashkia ku ata operojnë.

## Transporti publik

Transporti publik është fokusi kryesor i ligjit, i cili e përkufrizon atë si shërbime transporti që janë universalisht të aksesueshme në kushte të barabarta për të gjithë përdoruesit. Kjo kategori përfshin një gamë të gjerë shërbimesh siç janë autobusët që operojnë në linja të rregullta, linja urbane dhe periferike dhe linja ndërrurbane që lidhin komuna të ndryshme në mbarë Kosovën. Qëllimi i transportit publik, siç përcaktohet me ligj, është të sigurojë një mënyrë transporti të besueshëm, efikas dhe të sigurt për popullatën.

<sup>1</sup> Kosovë, Kuvendi i Republikës. Ligji Nr. 04/L-179 për Transportin Rrugor ., [https://cps.rks-gov.net/ep-content/uploads/2020/09/LAË\\_NO\\_04\\_L-179\\_ON\\_ROAD\\_TRANSPORT.pdf](https://cps.rks-gov.net/ep-content/uploads/2020/09/LAË_NO_04_L-179_ON_ROAD_TRANSPORT.pdf) .



Transporti i rregullt i udhëtarëve përkufizohet si transport përgjatë rrugëve fikse me orare dhe tarifa të paracaktuara. Këtu përfshihen forma të ndryshme transporti, si transporti urban, periferik dhe ndërurban.

Për **transportin urban dhe periferik**, komunat kanë autoritetin të organizojnë, rregullojnë dhe subvencionojnë shërbimet për të përmbushur nevojat e komuniteteve të tyre. Ata janë përgjegjës për projektimin e rrjetit të linjave urbane dhe periferike, përcaktimin e numrit të orareve dhe sigurimin që shërbimet e transportit të plotësojnë kërkesat e publikut, veçanërisht në zonat ekonomikisht të paqëndrueshme. Komunat mund të zgjedhin të subvencionojnë transportin publik për ta bërë atë më të përballueshëm për grupe të caktuara, si qytetarët me të ardhura të ulëta, studentët dhe të moshuarit. Ligji ofron gjithashtu kornizën për komunat për të krijuar partneritet me operatorët privatë të transportit në mënyrë që të sigurojnë mbulim të plotë të shërbimeve.

Transporti ndërurban, i cili lidh komuna të ndryshme, është nën juridiksionin e Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës. Kjo ministri është përgjegjëse për përcaktiminorareve dhe tarifave për këto shërbime, duke siguruar që transporti publik ndërurban të jetë i besueshëm dhe i qashtëm. Ministria rregullon gjithashtu shërbimet që përfshijnë transportin ndërkufitar ose rrugët ndërkombëtare, duke siguruar respektimin e ligjeve dhe marrëveshjeve kombëtare dhe ndërkombëtare të transportit.

Për më tepër, Udhëzimi Administrativ Nr. 26/2017<sup>2</sup> për Subvencionimin e Linjave Ekonomike të Paqëndrueshme të Transportit Ndërurban parasheh subvencione (prej 0.20 euro) për linjat ekonomikisht të paqëndrueshme ndërurbane, kur ka burime buxhetore.

Të gjithë operatorët e transportit publik duhet t'u përmbahen standardeve strikte teknike dhe të sigurisë për automjetet e tyre, si dhe duhet të respektojnë normat mjedisore, të sigurisë dhe të cilësisë të përcaktuara nga autoritetet përkatëse. Kjo përfshin mbajtjen e orareve të rregullta, operimin e automjeteve të sigurta dhe të pastra si dhe ofrimin e shërbimeve që plotësojnë nevojat e pasagjerëve, duke përfshirë ato me kërkesa të veçanta, si p.sh. për të moshuarit dhe invalidët.

## Përgjegjësitë për sigurimin e transportit publik

Përgjegjësia për ofrimin e shërbimeve të transportit publik ndahet ndërmjet Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunave, ku secili institucion luan një rol të veçantë, por plotësues në sigurimin e ofrimit të opsioneve të transportit efikas, të sigurt dhe të përballueshëm për publikun.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës ka përgjegjësinë kryesore për rregullimin dhe koordinimin e shërbimeve të transportit ndërurban dhe ndërkombëtar. Kjo përfshin mbikëqyrjen e funksionimit të terminaleve të autobusëve, linjave ndërurbane dhe rrugëve të transportit që kalojnë kufijtë komunalë. Ministria ka për detyrë të lëshojë licenca për operatorët që ofrojnë transport publik në këto linja, të vendosë standarde për automjetet dhe drejtuesit e mjeteve dhe të monitorojë pajtueshmërinë me rregulloret e sigurisë dhe cilësisë së shërbimit. Ministria luan gjithashtu një rol kritik në nxitjen e bashkëpunimit ndërkombëtar në sektorin e transportit, duke negociuar marrëveshje dypalëshe dhe shumëpalëshe për të lehtësuar shërbimet e transportit ndërkufitar.

Nga ana tjetër, komunat janë të ngarkuara me rregullimin dhe ofrimin e shërbimeve të transportit publik urban dhe periferik brenda territoreve të tyre. Detyrat e tyre përfshijnë krijimin e planeve gjithëpërfshirëse të transportit, krijimin dhe mirëmbajtjen e rrjeteve të linjave të autobusëve dhe sigurimin që operatorët t'u përmbahen orareve të përcaktuara dhe standardeve të shërbimit. Komunat janë gjithashtu përgjegjëse për certifikimin e mjeteve të përdorura në transportin urban, duke u siguruar që ato të plotësojnë kushtet teknike dhe sanitare të kërkuara për transport të sigurt pasagjerësh. Për më tepër, komunat kanë autoritetin të nxjerrin akte administrative që rregullojnë mënyrën se si ofrohen shërbimet e transportit publik, duke përfshirë vendosjen e rregullave për ndalesat e autobusëve, kufizimet e shpejtësisë dhe mirëmbajtjen e autobusëve. Ato kanë gjithashtu kompetencën për të lëshuar licenca për operatorët e angazhuar në shërbime taksi dhe transport lokal pasagjerësh.

Komunat gjithashtu mbajnë përgjegjësinë për subvencionimin e disa shërbimeve të transportit publik për të siguruar qasje për grupet e marginalizuara. Këtu përfshihen linjat urbane dhe periferike, veçanërisht ato që u shërbejnë qytetarëve ekonomikisht të paqëndrueshëm ose që ofrojnë shërbime thelbësore si transporti i studentëve ose personave me aftësi të kufizuara. Përmes këtyre subvencioneve, komunat synojnë të krijojnë një sistem transporti që i shërben të mirës publike duke ruajtur qëndrueshmërinë financiare. Për më tepër, komunat mund të rregullojnë shërbimet lokale të taksive, transportin falas dhe transportin për përdorim privat, duke i harmonizuar këto shërbime me kuadrin më të gjerë kombëtar të përcaktuar nga Ministria.

<sup>2</sup> Republika e Kosovës. Udhëzimi Administrativ Nr 26/2017 për Subvencionimin e Linjave Ekonomike të Paqëndrueshme të Transportit Ndërurban . Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, 30 shtator 2017, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=16319> . Qasur më 30 shtator 2024.

## Strategjia e transportit multimodal 2023-2030 dhe marrëveshjet Evropiane

Strategjia Multimodal e Transportit 2023-2030<sup>3</sup> e Kosovës thekson nevojën për sisteme të përmirësuara të transportit publik, duke integruar mënyra të ndryshme transporti për efikasitet, qëndrueshmëri dhe qasje më të madhe. Strategjia fokusohet në promovimin e multimodalitetit, ku metodat e ndryshme të transportit (rrugor, hekurudhor, autobus dhe ajror) janë të ndërlidhura për të ofruar shërbime pa probleme, me kosto efektive dhe miqësore me mjedisin për pasagjerët. Më poshtë janë të dhëna kryesore në lidhje me transportin publik nga dokumenti:

Strategjia nënvizon domosdoshmërinë e një sistemi transporti publik të integruar mirë për të rritur lëvizshmërinë nëpër qytete dhe rajone. Kjo përfshin zhvillimin e një qasjeje gjithëpërfshirëse për të lidhur shërbimet e lëvizshmërisë së autobusëve, hekurudhave dhe lokale për të siguruar udhëtim të qetë të pasagjerëve, si brenda zonave urbane ashtu edhe nëpër rajone. Për shembull, integrimi i shërbimeve të autobusëve ndërrurban me zgjidhjet e lëvizshmërisë urbane është theksuar si prioritet. Kjo do të përfshinte përmirësimin e lidhjeve të autobusëve, veçanërisht në zonat rurale, duke ofruar lehtësi të tilla si stacione parkimi dhe udhëtimi për transport më të qasshëm.

Koncepti i multimodalitetit në transportin e pasagjerëve është thelbësor për përmirësimin e transportit publik. Strategjia mbron krijimin e një sistemi të integruar ku pasagjerët mund të kalojnë lehtësisht midis mënyrave të transportit, të tilla si nga ecja ose çiklizmi në autobus ose hekurudhë. Multimodaliteti është veçanërisht i rëndësishëm për krijimin e shërbimeve efikase dhe tërheqëse të transportit publik. Për shembull, theksohet integrimi i sistemeve të informacionit dhe biletave, duke i lejuar pasagjerët të kenë qasje në të dhëna në kohë reale dhe bileta të harmonizuara nëpër mënyra të ndryshme transporti.

Ekziston nevoja për të modernizuar infrastrukturën e transportit publik, veçanërisht autobusët dhe hekurudhat, për të përmbushur standardet më të larta të shërbimit dhe sigurisë. Shumë nga automjetet e përdorura në transportin publik, veçanërisht autobusët, janë të vjetruara dhe kërkojnë përmirësim. Për më tepër, sistemet e fragmentuara dhe të vjetruara të informacionit për blerjen e biletave dhe orarin e komplikojnë më tej funksionimin efikas të transportit publik. Strategjia kërkon zbatimin e sistemeve të informacionit në kohë reale dhe modernizimin e flotës së automjeteve për të ofruar transport të besueshëm, të sigurt dhe miqësor ndaj mjedisit.

<sup>3</sup> Republika e Kosovës, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës. Strategjia e Transportit Multimodal 2023-2030. Qeveria e Kosovës, 2023, [https://mit-ks.net/repository/docs/2024\\_05\\_13\\_195223\\_MTS\\_ANG.pdf](https://mit-ks.net/repository/docs/2024_05_13_195223_MTS_ANG.pdf)

<sup>4</sup> Komisioni Evropian. Marrëveshja e Gjellbër Evropiane . Bashkimi Evropian, [https://commission.europa.eu/strategy-and-policy/priorities-2019-2024/european-green-deal\\_en](https://commission.europa.eu/strategy-and-policy/priorities-2019-2024/european-green-deal_en). Qasur më 27 shtator 2024 .

Strategjia thekson gjithashtu rëndësinë e bërjes së transportit publik të qasshëm për të gjitha grupet, duke përfshirë njerëzit me aftësi të kufizuara dhe ata me lëvizshmëri të reduktuar. Kjo përfshin modernizimin e stacioneve të autobusëve dhe stacioneve për të akomoduar nevojat e të gjithë pasagjerëve, duke përmirësuar përvojën e përgjithshme të përdoruesit.

Transporti publik pritet gjithashtu të luajë një rol kyç në uljen e ndikimit mjedisor të sektorit të transportit. Duke kaluar nga veturat private në opsionet e transportit publik, siç janë autobusët dhe hekurudhat, Kosova synon të ulë emetimet dhe mbipopullimin. Strategjia gjithashtu promovon dixhitalizimin e shërbimeve të transportit, duke futur sisteme elektronike të biletave dhe informacionit për ta bërë transportin publik më efikas dhe më miqësor për përdoruesit.

Në përgjithësi, strategjia thekson modernizimin e sistemit të transportit publik të Kosovës si një hap kritik drejt ndërtimit të një rrjeti transporti më të qëndrueshëm, më të qasshëm dhe të integruar, i cili përputhet me qëllimet e anëtarësimit të vendit në BE dhe angazhimet mjedisore.

## Marrëveshja e gjellbër evropiane dhe direktivat e BE-së

Mbrojtja e mjedisit parashikohet gjithashtu nga Marrëveshja e Gjellbër Evropiane, e cila promovon lëvizjen e mallrave nga transporti rrugor drejt hekurudhave dhe rrugëve ujore të brendshme, të cilat mund të ulin ndjeshëm emetimet. Për të lehtësuar këtë zhvendosje, nevojiten investime të konsiderueshme për modernizimin dhe zgjerimin e infrastrukturës hekurudhore. BE-ja kërkon gjithashtu të përmirësojë sistemet e transportit publik, duke i bërë ato më të qasshme, të besueshme dhe të përbalueshme.

Kjo qasje synon të ulë varësinë nga makinat private dhe të reduktojë emetimet e përgjithshme të transportit<sup>4</sup>.

Për më tepër, Bashkimi Evropian (BE) ka qenë në ballë të përpjekjeve për të promovuar zhvillimin e qëndrueshëm, me transportin publik që luan një rol kryesor në arritjen e këtij qëllimi. Përmes një sërë direktivash, BE-ja ka formësuar politika që inkurajojnë shtetet anëtare dhe vendet kandidatë të reduktojnë ndotjen, të përmirësojnë cilësinë e ajrit dhe të nxisin një sektor më të gjellbër të transportit. Ky rishikim i literaturës eksploron direktivat kryesore të BE-së në lidhje me transportin publik dhe ndikimin e tyre të përgjithshëm në qëndrueshmërinë mjedisore.

Disa direktiva të rëndësishme të BE-së janë miratuar për të adresuar implikimet mjedisore të transportit. Një nga më të dukshmet është Direktiva 2008/50/EC<sup>5</sup> për cilësinë

<sup>5</sup> Parlamenti Evropian dhe Këshilli i Bashkimit Evropian. Direktiva 2008/50/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 21 maj 2008 për cilësinë e ajrit të ambientit dhe ajrin më të pastër për Evropën . EUR-Lex, 11 qershor 2008, <https://eur-lex.europa.eu/eli/dir/2008/50/oj>. Qasur më 30 shtator 2024 .

e ajrit të ambientit, e cila përcakton vlerat kufi për ndotës të ndryshëm të ajrit, duke përfshirë oksidet e azotit dhe grimcat dhe inkurajon përdorimin e mënyrave më të pastra të transportit, si transporti publik, për të reduktuar emetimet. Një tjetër direktivë kritike, 2009/126/EC<sup>6</sup>, fokusohet në ndërveprueshmërinë e sistemeve hekurudhore brenda Bashkimit Evropian. Kjo direktivë promovon zhvillimin e një rrjeti të unifikuar hekurudhor në të gjithë Evropën, duke rritur efikasitetin dhe atraktivitetin e transportit publik me bazë hekurudhore. Direktiva 2014/94/BE<sup>7</sup> për vendosjen e infrastrukturës së karburanteve alternative synon të lehtësojë kalimin në lëndë djegëse alternative, si energjia elektrike dhe hidrogjeni, për automjetet e transportit publik.

Zbatimi i këtyre direktivave ka ndikuar ndjeshëm në sistemet e transportit publik nëpër shtetet anëtare të BE-së dhe vendet candidate. Qeveritë kanë rritur investimet e tyre në modernizimin e infrastrukturës së transportit publik, zgjerimin e rrjeteve dhe promovimin e përdorimit të automjeteve elektrike dhe hibride. Kjo shtytje për lëndë djegëse alternative ka çuar në miratimin e gjerë të autobusëve dhe trenave elektrikë dhe hibridë. Duke reduktuar varësinë nga makinat private dhe duke promovuar mënyra më të pastra transporti, këto direktiva kanë kontribuar gjithashtu në përmirësimin e cilësisë së ajrit, veçanërisht në zonat urbane. Për më tepër, fokusi në rritjen e ndërveprueshmërisë e ka bërë më të lehtë për pasagjerët të udhëtojnë përtej kufijve duke përdorur sistemet e transportit publik.

Në përputhje me Marrëveshjen e Gjellbër të BE-së, Strategjia për Lëvizshmëri të Qëndrueshme dhe të Mençur në Ballkanin Perëndimor<sup>8</sup> shërben si një kornizë kyçe për adresimin e sfidave urgjente të ndryshimeve klimatike dhe degradimit të mjedisit në rajon. Kjo strategji ka si synim promovimin e automjeteve me emetim zero dhe zhvillimin e infrastrukturës përkatëse, si stacionet e mbushjes elektrike dhe burimet alternative të karburantit. Kjo është thel-

bësore për të zvogëluar varësinë nga karburantet fosile dhe për të minimizuar ndotjen e ajrit. Një objektivi tjetër i rëndësishëm është integrimi i mënyrave të qëndrueshme të transportit për të ofruar zgjidhje multimodale dhe neutrale ndaj klimës, duke përmirësuar lidhjet hekurudhore dhe sigurimin e udhëtimeve të pandërprera në të gjithë rajonin. Strategjia gjithashtu thekson rëndësinë e zhvillimit të infrastrukturës së gjellbër dhe transformimit dixhital të sistemeve të transportit, si dhe qasjen e unifikuar për stimuj që nxisin adoptimin e opsioneve të qëndrueshme të transportit.

Sektori i transportit në Ballkanin Perëndimor është një kontribues i rëndësishëm në emetimet e gazeve serrë, duke përfshirë transportin rrugor, aviacionin vendas dhe rrugët ujore të brendshme. Përdorimi i automjeteve elektrike dhe hibride mbetet shumë i ulët, kryesisht për shkak të mungesës së infrastrukturës dhe stimujve. Strategjia thekson se është e nevojshme një qasje më sistematike për të adresuar këto emetime, përmes strategjive kombëtare që përfshijnë elementë të gjellbër. Për të arritur tranzicionin drejt lëvizshmërisë së qëndrueshme dhe të mençur, strategjia propozon një udhërrëfyes që përfshin transpozimin e legjislacionit të BE-së, zhvillimin e infrastrukturës elektrike për automjete, kryerjen e studimeve të fizibilitetit për karburantet alternative dhe përafrimin e standardeve të emetimeve në të gjithë rajonin.

Pavarësisht arritjeve të deritanishme të shteteve anëtare dhe candidate të BE-së, mbeten disa sfida. Një nga pengesat kryesore është sigurimi i fondeve adekuate për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e vazhdueshme të sistemeve të transportit publik të qëndrueshëm. Planifikimi efektiv urban është gjithashtu vendimtar në krijimin e mjedisëve që i japin përparësi transportit publik dhe dekurajojnë përdorimin e makinave private. Për më tepër, kërkimi dhe zhvillimi i vazhdueshëm nevojiten për të adresuar sfidat teknologjike dhe për të përmirësuar efikasitetin dhe qëndrueshmërinë e përgjithshme të sistemeve të transportit publik.

<sup>6</sup> Parlamenti Evropian dhe Këshilli i Bashkimit Evropian. Direktiva 2009/126/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 21 tetor 2009 për Rikuperimin e avullit të benzinës në fazën II gjatë mbushjes me karburant të automjeteve në stacionet e shërbimit. EUR-Lex, 21 tetor 2009, <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A32009L0126>. Qasur më 30 shtator 2024.

<sup>7</sup> Parlamenti Evropian dhe Këshilli i Bashkimit Evropian. Direktiva 2014/94/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 22 tetor 2014 për vendosjen e infrastrukturës së karburanteve alternative. EUR-Lex, 22 tetor 2014, <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=celex%3A32014L0094>. Qasur më 30 shtator 2024.

<sup>8</sup> Sekretariati i Përhershëm i Komunitetit të Transportit. Strategjia për lëvizshmëri të qëndrueshme dhe të zgjuar në Ballkanin Perëndimor 2021. Marrë nga <https://ëëë.transport-community.org/ëp-content/uploads/2021/06/Strategy-for-Sustainable-and-Smart-Mobility-in-the-Eastern-Balkans.pdf>

## Metodologjia

Ky studim përdori një qasje me metoda të kombinuara për të mbledhur të dhëna për përdorimin dhe perceptimet e iniciativës së shërbimit falas të autobusëve në Kamenicë. Për të kuptuar vlerësimin gjithëpërfshirës të ndikimit dhe opinionit publik, u përdorën metoda sasiore dhe cilësore të mbledhjes së të dhënave.

### Shpërndarja e anketave

Një anketë e strukturuar u hartua dhe u realizua me 170 përdorues të autobusëve në stacione të ndryshme të autobusëve nëpër Kamenicë për një periudhë prej shtatë ditësh në shtator 2024. Qëllimi i anketës ishte të mblidhte informacion të detajuar mbi përdorimin e shërbimit, kënaqësinë e përdoruesve të autobusit si dhe informacionet demografike. Pyetjet e anketës synonin të kapnin shpejtësinë e përdorimit të autobusit, arsyet e përdorimit të autobusit, perceptimet rreth qasjes, kënaqësinë e publikut me shërbimin dhe opinionet mbi ndikimet mjedisore.

Plani i shpërndarjes së anketave fillimisht ishte e planifikuar që të shpërndahej në mënyrë të barabartë në të shtatë ditët (me fundjavat e mbipopulluara). Megjithatë, për shkak të numrit dukshëm shumë të ulët të qytetarëve që përdorin shërbimin e autobusit të dielave, shumë të anketuar ishin të intervistuar të përsëritur. Si rezultat, ishte e nevojshme të rishpërndahehin anketat gjatë ditëve të mbetura për të shmangur dyfishimin e përgjigjeve të qytetarëve dhe për të siguruar një mostër përfaqësuese. Plani fillestar ndau një numër të caktuar anketash në ditë, duke synuar mbulimin e balancuar gjatë orëve më të ngarkuara dhe stacioneve të ndryshme të autobusëve. Tabela e mëposhtme ilustron shpërndarjen e përditësuar të anketave pas grumbullimit të të dhënave:

Dita	Numri i anketave të mbledhura
11 shtator	35
12 shtator	25
13 shtator	25
14 shtator	15
15 shtator	0
16 shtator	29
17 shtator	21
18 shtator	20

Tabela 1. Shpërndarja e anketave sipas ditëve të javës

### Intervistat e thelluara

Përveç të dhënave të anketës, tre intervista me akterë kyç u kryen me palët e mëposhtme të interesit:

- Shoferi i autobusit:** Për të fituar njohuri mbi sfidat operacionale, rutinat e përditshme dhe bashkëpunimin me pasagjerët.
- Zyrtare lokale nga komuna e Kamenicës:** Intervista u mbajt me një përfaqësuese të Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik dhe Diasporë për të kuptuar ndikimet në nivel komuniteti dhe se si shërbimi falas i autobusëve ndikoi në trafikun e qytetit dhe politikat lokale.
- Përfaqësuesi i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës:** Intervista u mbajt me Departamentin e Shërbimeve të Transportit Rrugor për të ofruar një perspektivë më të gjerë se si nisma e autobusëve falas përputhej me qëllimet dhe politikat kombëtare të transportit.

Ky studim përdori një qasje me metoda të kombinuara për të mbledhur të dhëna për përdorimin dhe perceptimet e iniciativës së shërbimit falas të autobusëve në Kamenicë. Për të siguruar një kuptim gjithëpërfshirës të ndikimit dhe opinionit publik, u përdorën metoda sasiore dhe cilësore të mbledhjes së të dhënave.

## Rezultatet dhe diskutimet

Gjetjet e paraqitura më poshtë rezultojnë nga të dhënat e mbledhura nga anketat dhe intervistat e realizuara me akterët kyç. Diskutimi fillon duke shqyrtuar arsyet kryesore që kanë çuar në fillimin e iniciativës, bazuar në intervistat me zyrtarët lokalë të komunës së Kamenicës dhe përfaqësuesin nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Më pas përmbledhen të dhënat e anketës, duke ofruar një përshkrim të profilit demografik të të anketuarve. Analiza përqendrohet në gjithpërfshirjen e qytetarëve në përdorimin e autobusit falas, si dhe në nivelet e kënaqësisë së tyre. Po ashtu, shqyrtohen perceptimet dhe sjelljet e tyre, të cilat ndikohen nga faktorët mjedisorë. Diskutimi vazhdon me ndikimin që ka shërbimi në trafikun urban, burimet e informacionit që kanë përdorur qytetarët për të mësuar mbi iniciativën dhe gatishmërinë e tyre për të paguar për këtë shërbim. Gjithashtu, trajtohen opinionet e tyre për përmirësimet e mundshme në linjën ekzistuese të autobusëve. Në fund, analizohet preferenca për dixhitalizimin e shërbimeve të autobusëve.

Gjetjet janë paraqitur në një nivel të përgjithshëm, por janë gjithashtu të ndara sipas llojit të vendbanimit (urban /rural) dhe grupmoshës, aty ku vërehen dallime të rëndë-

### Arsyet prapa nismës së autobusëve falas dhe planet e së ardhmes

Kjo nismë e autobusit falas, sipas zyrtarit komunal, doli nga nevojat e shprehura nga grupe të ndryshme të qytetarëve, përfshirë të moshuarit, të rinjtë dhe gratë. Ishte një shqetësim i përsëritur i shprehur në diskutimet në komunitet, i nxitur nga sfidat e paraqitura nga gjeografia e komunës, e cila përfshin një popullsi relativisht të vogël por të shpërndarë në një territor mjaft të gjerë me të gjitha fshatrat. Mungesa e shërbimeve të shpeshta të autobusëve, me vetëm një linjë që funksiononte çdo ditë, u konsiderua e pamjaftueshme, duke ndikuar negativisht në aspekte të shumta të jetës së përditshme, duke përfshirë qasjen në arsim, kujdes shëndetësor dhe punësim. Duke cituar:

***“Kjo nismë ka nisur si kërkesë e të moshuarve, të rinjve dhe grave. Gjithmonë është ngritur si shqetësim në takimet tona të hapura. Nevoja për një lidhje më të madhe mes qytetit dhe fshatrave është shumë***

***e madhe sepse shpesh fshatrat janë të izoluar për shkak të mungesës së transportit.” (Intervistë me zyrtaren komunale).***

Sipas tyre, një aspekt thelbësor i nismës është synimi për përmirësimin e lidhjes mes qytetit dhe zonave rurale. Shumë fshatra janë të izoluar për shkak të mungesës së transportit të qëndrueshëm, duke kufizuar qasjen në shërbimet publike, tregje, shkolla dhe mundësitë punësimi. Ky izolim ka pasur një ndikim të rëndësishëm, veçanërisht tek të rinjtë që nuk mund të marrin pjesë në sesione të ndryshme trajnimit apo aktivitete të ndryshme për shkak të mungesës së transportit.

Nisma, sipas zyrtares komunale, përputhet edhe me qëllimet më të gjera të reduktimit të trafikut dhe qëndrueshmërisë mjedisore. Duke ofruar transport publik falas, pushteti lokal parashikon uljen e përdorimit të automjeteve private, veçanërisht nga punonjësit në arsim, administratë, shëndetësi dhe sektorë të tjerë. Ky ndryshim mund të çojë në më pak makina në rrugë dhe të kontribuojë në “agjendën e gjelbër” të komunës, duke nxitur përfitime mjedisore dhe ekonomike.

